



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MEDIAVE AUDIOVIZIVE

Njoftim për media

Të mërkurën, më datë 01.04.2015, u zhvillua mbledhja e radhës e Këshillit të Autoritetit të Mediave Audiovizive, në prani të anëtarëve të mëposhtëm:

Z. Gentian Sala Kryetar

Z. Gledis Gjipali Anëtar

Z. Piro Misha Anëtar

Z. Zylyftar Bregu Anëtar

Pas shqyrtimit të çështjeve të rendit të ditës u miratuan vendimet si më poshtë:

1. “Për shqyrtimin dhe miratimin e Bilancit vjetor të Autoritetit të Mediave Audiovizive për vitin 2014”;
2. “Për zëvendësimin e licencave të subjekteve televizivë privatë kabllorë me autorizim për ripërsëritjen e shërbimit të programit audioviziv të të tretëve”;
3. “Për shqyrtimin e disa ndryshimeve në të dhënat e paraqitura në kërkesën për marrje autorizimi nga subjektet persona fizikë Gentian Biqiku dhe Dritan Hida”;
4. “Mbi shqyrtimin e kërkesës së paraqitur nga shoqëria “Belkisa” sh.p.k, licencuar për subjektin radiofonik privat vendor “Radio 1”.

Gjithashtu u morën në shqyrtim aplikimet e paraqitura nga subjektet kabllorë për marrje autorizimi për ripërsëritjen e programeve audiovizivë të të tretëve mbështetur në një rrjet kabllor dhe në përfundim Këshilli vendosi për Mosdhënien e Autorizimit për: Tv kabllor Andor.

Këshilli vendosi që të rimarrë në shqyrtim aplikimet e paraqitura nga Tv Eden 3 dhe Zjarr Tv në një kohë të dytë, për shkak të mungesës të kuorumit të nevojshëm për vendimmarrje.

Po ashtu Këshilli i AMA me votim zgjodhi sekretaren e Këshillit.

Tiranë më 1 Prill 2015